



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	17.09.2026
REFERENC-Ë:	26/1222/MMPH
PËR/ZA/TO:	"Kemi Petroll" Ferizaj Bazë e prodhimit të betonit në Prelez të Jerlive- Ferizaj
CC:	Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për Lejë Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Bajram Kafexholli, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për ndërprerje të procedurës administrative

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) ka kontrolluar kërkesën për vazhdim të Lejes Mjedisore, me nr. prot. 26/3435/MMPH, datë 16.03.2026, të parashtruar nga operatori N.T.P. "Kemi Petroll" Ferizaj për bazën e prodhimit të betonit në Prelez të Jerlive- Ferizaj.

MMPH, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur dhe një sërë takimesh, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur.

Bashkangjitur kësaj shkrese gjeni:

1. Vendimi për ndërprerje të procedurës administrative të kërkesës për vazhdim të Lejes Mjedisore për operatorin N.T.P. "Kemi Petroll" Ferizaj për bazën e prodhimit të betonit në Prelez të Jerlive- Ferizaj.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 26/1222/MMPH
Datë: 17.09.2026

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr.03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, nenit 10, paragrafit 3 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ MMPHI- Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

Operatorit N.T.P. "Kemi Petroll" Ferizaj, i ndërpritet procedura administrative për kërkesën me nr. prot. 26/1222/MMPH, datë: 16.03.2026, për vazhdim të Lejes Mjedisore, me nr. ref. 19/4356/611/DMMU, dt. 04.02.2020, për bazën e prodhimit të betonit në ngastrën kadastrale nr. P-722170045-00981-1, zona kadastrale Prelez të Jerlive- Ferizaj..

A r s y e t i m

Pas pranimit të kërkesës për vazhdim të Lejes Mjedisore me nr. prot. 26/1222/MMPH, datë: 16.03.2026, të operatorit N.T.P. "Kemi Petroll" Ferizaj për bazën e prodhimit të betonit në Prelez të Jerlive- Ferizaj, Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisore ka kontrolluar lëndën administrativisht dhe në përputhje me nenin 10, paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022, ka kërkuar nga operatori plotësim të dokumenteve me datë 24.07.2026 si në vijim:

Faqe 2 nga 3

- Pëlqimi Mjedisor ne baze te cilit është lëshuar Leja Mjedisore paraprake;
- Lejen ujore për shfrytëzim te ujit nga ARPL;
- Leje Ujore për shkarkim te ujit nga ARPL.
- Lejen per aktivitete te veçanta nga KPMM per betoniere.

Operatori nuk ka sjellur dëshmi për plotësimin e dokumentacionit shtesë të kërkuar.

Komisioni për Leje Mjedisore ne takimin e mbajtur me datë 25.08.2026, konstatoi se operatori N.T.P. "Kemi Petroll" Ferizaj për bazën e prodhimit të betonit në Prelez të Jerlive-Ferizaj, nuk i plotëson kriteret e parapara për fillimin e shqyrtimit të kërkesës për vazhdim të Lejes Mjedisore, pasi që nuk e ka kompletuar dokumentacionin e cekur me lartë në afatin kohorë të përcaktuar nenin 10 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, mbyll procedurën administrative në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për ri aplikim sipas procedurës së rregullt.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Bajram Kafexholli

U.D i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së

Vendimi i 'u dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës;
- DMM-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPH-së;
- Arkivit të MMPH-së.